



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. Protokolit:

Data: 08.11.2024 060/01-9/307

Për: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF

FTESE

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e X të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Mbledhja do të mbahet me dt. 18.11.2024 (Hënë), ora: 10:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesat.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.10.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin pas diskutimit publik të Draft Plani të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës – 2025.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin e Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin pas diskutimit publik të Draft - Planit Lokal të Veprimtimit Për Barazinë Gjinore, 2024 – 2027.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i informatës për ndarjen e bursave për student.
7. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar. (Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Premten, me dt.15.11.2024).





SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ
KOMITET ZA POLITIKU I FINANSIJE
Br. Protokola: 060/01-91307
Datum: 08.11.2024
Za: Članove Komiteta za Politiku i Finansije-KPF

POZIV

Poštovani članovi/članice, pozivamo vas da čestvujete na X sednici Komiteta za Politiku i Finansije za 2024. Godinu, koja će biti održana 18.11.2024 (u ponedjeljak) u Sali Komiteta za Politiku i Finansije.

Napomena: Komitet za Politiku i Finansije zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

DNEVNI RED

1. Učešće i odsustvo članova na sednici.
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika KPF-a od 18.10.2024.
3. Razmatranje i preporučivanje nacrtu Plana Rada SO za 2025. Godinu, posle postupka javne rasprave.
4. Razmatranje i preporuka kalendara sednice Komiteta za Politiku i Finansije i Skupštine Opštine Peć za 2025. Godinu.
5. Razmatranje i preporučivanje nacrtu Lokalnog Akcionog Plana za Rodnu Ravnopravnost za period 2024 – 2027.
6. Razmatranje i preporučivanje Skupštini informacija o dodeli stipendija za studente.
7. Pitanja i predlozi u vezi rada Opštine, istaknuti od članova, po redosledu po kome su primljeni. (Dostaviti Sekretaru ne kasnije od petka, dana 15.11.2024).

PRESEDAVAJUĆI KPF-a
g-din Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-84027

Pejë, datë: 17 Tetor 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i **IX-** i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **17 tetor 2024**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Drejtoreshë e Financave, znj. Diellza Berisha, ZKF, znj. Hajrije Haxhijaj, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Nysret Hajrizi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, Zyrtare Administrative, znj. Donjeta Morina, Asistente e kryesuesit, znj. Florlinda Berisha, dhe përfaqësuesit e ZIP-it dhe OSBE.

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë dhe deklaroi se rendit të ditës j'u shtu edhe një pikë shtesë.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite, me 9 vota pro, kundër nuk ka, të përmbajtur nuk ka.

Rendi i Ditës

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 16.09.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin e normës tatimore për tatimin në pronë në Komunën e Pejës, për vitin 2025.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin e propozimit për faljen e borxheve në taksa afariste për bizneset që kanë operuar dhe operojnë në Komunën e Pejës.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i raportit financiar të Komunës së Pejës për periudhën Korrik – Shtator 2024.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i informatës për gjendjen ekonomiko-financiare në Komunën e Pejës.
8. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 16.09.2024

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohet procesverbali i KPF-së i dt.16.09.2024

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin e normës tatimore për tatimin në pronë në Komunën e Pejës, për vitin 2025.

Znj.Diellza Berisha: deri në vitin e kaluar vlersimi i pronave ka qenë vlersim i veçantë për krejt kategorit e kemi një vlersim, sivjet ka ndru ligji dhe tash e kemi vlersimin e kombinuar deri në vlerë 100 mijë euro e kemi vlerë minimale. Kemi propozu që me shku me vlerë minimale 0.10%, ndërsa me vlerë mbi 100 mijë euro shkon me 0.20%. Kjo çka e kanë marr vendim për ligj Ministria e Financave i dëmton bizneset! Ne i kemi mar disa shembuj, disa bizneseve p.sh e marim hotel “Dukagjini” deri vjet ka pagu tatim 80 mijë euro sivjet i shkon tatimi 225 mijë euro. Sa kanë me u demtu tash bizneset po e shohim edhe vet, por kjo është ma e shumta që mundemi me bo na si komunë! Kemi shku me vlerë minimale 0.10% me vlersim të kombinuar dhe shembull të tillë e kanë ndjek edhe komunat e tjera! Diqka tjeter na nuk kemi mujt me bo kjo normë është progresive ndron çdo 2 vitë, minimumi që mundet me mbajt këtë vlerë është dy vite. Ne kemi vendos që këtë vitë me shku me 0.10%, e vitin tjeter e shohim çfarë vendimi i propozojmë asamblesë komunale!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 8 vota pro, 1 anëtar nuk ka mar pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim norma tatimore për tatimin në pronë në Komunën e Pejës, për vitin 2025.

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin e propozimit për faljen e borxheve në taksa afariste për bizneset që kanë operuar dhe operojnë në Komunën e Pejës.

Z. Nasret Hajrizi: është një taksë që ka fillu me u apliku në vitin 2002, mirpo realisht forma e inkasimit ajo që ka qenë në atë periudhë dhe nuk janë inaksu. Gjatë bisedimeve me kryetarin dhe me drejtorinë e financave, me ZKF-në dhe me zyrtarët e USAID kemi ardh në përfundim që është momenti të fillohet falja e kësaj takse, realisht këtij obligimi. Ngase në auditmin e jashtëm po na qet pak problematik po del si pozicion i mjeteve të pa inkasume. Po ashtu sa e di unë të gjitha afatet ligjore kanë skadu për inkasimin e kesaj takse. Janë pothuajse mbi 6 milionë euro kanë me u fal dhe kanë me përfitu qato bizneset që kanë operu ketë taks deri në vitin 2012. Ndërsa në fund të vitit 2012 ish kryetari z.Ali Berisha ka marr vendim të hiqet kjo taksë, dhe kanë mbet si obligim i pa inkasuar. Dhe e kemi sjellë si propozim në kuvend për me mar vendim me u pastru ky pozicion i obligimit që është obligim që figuron, mirpo realisht nuk është obligim për biznese!

Z. Labinot Panxha: unë, fillimishtë dua me ja bo një pyetje drejtorit a po bëhet falja e borgjeve nga viti 2002-2012 a nga viti 2012 deri me sot?

Z.

Nasret Hajrizi: jo nga viti 2002 deri në fund të vitit 2012!

Z.Labinot Panxha : faleminderit për sqarim, e the edhe vet që ky borgj është i parashkrum dhe komuna nuk po e fal borgjet. Por është i parashkrum dhe si i tillë duhet me u fshi, dhe secili që është i ngarkum me ketë taksë e bën një padi përshlyrjen e ketij borgji e fiton dhe e ngarkon komunën me takasa administrative. Unë, mendoj që mirë që e keni marr ketë iniciativen, mirpo realishtë nuk i bjen falje. Po ashtu po e kuptoj edhe që jemi në fushatë zgjedhore dhe me dal para opinionit që po i ndihmojmë bizneset me faljen, mirpo kjo nuk po falet por po fshihet një ligj që është i parashkrum dhe si i tillë duhet të fshihet. Dhe nese e kishit ndru aty faljen sigurishtë që e kishit pas mbështetjen tonë me votë, mirpo kjo falje nuk është!

Z.Nasret Hajrizi: ne kemi raste edhe ma heret kur z.Isa Mustafa e ka dërgu në kuvend borgjet e pa inkasushme dhe kuvendi i ka fal dhe e ka qit aty falja!

Z.Labinot Panxha: sqarimin që e bënet ju dhe sqarimin që e bëra unë janë dy të ndryshme falje dhe parashkrim, ju po thuni i kemi fal dhe unë po them janë parashkru, me rendsi ata nuk kanë me u inkasu mirpo nuk është falje por borgji i parashkrum.

Znj. Hajrie Haxhijaj: duke e marr parasysh që BE-ja e ka pa si barrë për biznese dhe BE e ka bë rekomandimin që bizneset mos të ngarkohen me takasa, në menyrë që të bëhet një midis më i mirë biznesorë dhe të gjitha komunat e kanë mar vendimin 2012 që bizneset mos të ngarkohen me këtë taksë.

Z.Nasret Hajrizi: ne e kemi praktiku dhe e kemi pa edhe te disa komunat e tjera dhe ata kur e kanë bë propozimin për heqje e kanë shkru falje.

Z.Berat Ganiqi: qysh po shihet falja është nga periudha 2002-2012 mirpo diqka e kam të pa qartë 6 milionë euro dhe se ne nuk e kemi këtu se cilave biznese dhe qfare shume po ju falet. Këtu para nesh nuk ka asnjë tabele që tregon se cilat biznese jemi duku j'u fal. Po ashtu është e pafalshme nese komuna nuk ka arit me fitu këtë borgj sepse edhe ne kohen kur e ka mar kjo qeverisje momentale lokale ka mujt me bo padi me i nxir! Po për mua është e pafalshme nese një biznesi të madh që ka qarkullim të madh i falet një shumë e madhe me krahasu me një dyqan në qarshi 20 euro e dikujt 1 milionë euro. Nuk e di për qfarë biznese bëhet fjalë, mirpo po shihet që po bëhet fjalë për biznese të mëdha sepse bizneset e vogla nuk kanë mujt me pas tonë këtë taksë! Me dit pak aa shumë se qfare biznese po i falim, edhe pse nuk po i falim siq tha parafolësi im por me ditë cilat janë bizneset qfare taksa?Çfare shume?

Z.Nasret Hajrizi: realishtë kjo nuk ka qenë taksë në qarkullim, ka qenë taksë në operim, janë regjistru N.T.P, SH.P.K etj. Pamvarsishtë se qfare qarkullimi ka pas biznesi i athershem, nuk është tatimu në bazë të qarkullimit. Këtë të drejtë e ka ATK-ja në bazë të qarkullimit, ne nuk e kemi atë të drejtë në bazë të qarkullimit por e kanë qit athere në bazë të thirrjes N.T.P, SH.P.K etj. Ndërsa sa i perket listes po e kemi listen por është listë vulimunoze që i ka mbi 1 mijë faqe dhe muj me ju dërgu, por është listë çdo vjet janë regjistru të njejtit operatorë, mundem me ju përcjellë listen.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 votë pro, 2 votë të përmbajtur i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi për faljen e borxheve në taksa afariste për bizneset qe kanë operuar dhe operojnë në Komunën e Pejës

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Z.Diellza Berisha: ky material që e keni pranë ju me 30 shtator në bazë të afateve ligjore i ka shku zyres së auditimit. Pas pranimit të raportit të auditimit janë gjithësej 12 rekomandime, se qka kei bë na si komunë në bashkëpunim me USAID. Kemi kriju një grup punues i cili ka pas për qëllim me u marr me zbatimin e rekomandimeve. Deri tash kemi shku 33% , duke krahasuar që vitin e kaluar kanë qenë 0% të zbatimit të rekomandimeve. Periudha e dytë e raportimit të rekomandimeve është në mars dhe pritët që deri athere me shku 60%. Arsyeja pse disa rekomandime nuk mundemi me i zbatu është fakti për shkak të kontrates kolektive që ka ndiku

edhe te këto rekomandime. Një pikë që na qetë plus është falja e borgjit që ka me shku përmes kuvendit, është një rekomandim që hyn si e zbatume nese veq kalon! Po ashtu edhe diçka tjetër që kemi bë në bashkpunim me USAID është që edhe kryetari ka dërgu urdhëresa për pagimin e faturave në afate kohore për E-Prokurim. Ndërsa sa i i perket pagesave në pronë jemi dal në teren dhe pothuajse i kemi zbatu disa nga rekomandimet e theksuara.

Z.Labinot Panxha: është interesant se në çdo plan të veprimit edhe ne çdo rekomandim të auditorit të përgjithëshem komuna pajtohet, por në realitet asnihere nuk e zbaton. Drejtoresha na tha që kemi shku nga 0% në 33% mirpo ne nuk po shohim një gjë të tillë! Po ashtu ju po ndaleni te kjo kontrata kolektive që e kom fillu mandatin e asambleistit dhe po e përfundoj duke i dëgju qoftë drejtor qoftë kryetarin duke u anku në kontraten kolektive se po na qet më së keqti në botë neve dhe auditori po na cilëson si të kualifikuar. Por nuk është e vërtet kjo sepse auditori i ka disa vërejtje në fusha të tjera, përveq kontrates kolektive dhe të hyrave ose detyrimet që kanë dal prej kontrates së detyrimeve. Gjithashtu është interesant për mua dhe për juve se ky plan i veprimit që e keni bë zbatimin e rekomandimeve të auditorit me u përmbush të pakten deri në vitin që vjen. Sepse deri me sot unë nuk e kam pa që asnjë rekomandim të auditorit të përgjithëshem edhe për kundër faktit që komuna është pajtu me i zbatu, nuk i ka zbatu. Por po besoj ndoshta edhe ju drejtoreshë që e keni mar mandatin dhe nuk e pata rastin me të përgëzuar, ndoshta është edhe një fat i madhë për juve si drejtoreshë që deri në përfundim të mandatit, këto komuna e i zbatu në mënyrë të tërsishme sipas rekomandimeve të auditorit.

Znj.Hajrije Haxhijaj: vetem dua me sqaru se ne e dim që në këtë raport të auditimit janë të gjeturat, por të gjeturat nuk e kanë sjellë deri te kualifikimi i raportit. Janë disa kriteret që zyrja e kombëtare auditimit i ka në fokus në lidhje me kualifikimin e opinionit apo me moskualifikimin e opinionit. Unë, e kam cekur shumë herë është edhe keqklasifikim është si kategori, se nese ki keqklasifikimi athere ndrohet opinionit, nese ke rritje apo zbritje të detyrimeve kontigjente, mosprezentimi i mirë i regjistrimit të pasurive, mos prezentimi i mirë i tabelave fillestare të shpenzimit të buxhetit. Këto janë kriteret që ndikojnë në kualifikim të opinionit! Të gjeturat që janë por neve për kualifikim të opinionit na ka ardh për arsye se kemi pas keqklasifikimi. Keqklasifikimin po e kuptoni do me thënë shpenzimi i një kategorisë ekonomike në kodin jo përkatës. Pagat dhe meditet janë ekzekutu prej investimeve kapitale, prej mallrave dhe shërbimeve edhe kjo ka ardh deri te ndrimiit prej opinionit të pakualifikuar në opinion të kualifikuar.

Z.Labinot Panxha: a ka ndiku te opinionit i kualifikuar mosrespektimi i kontratave të pronave që janë dhënë me qirra konkretishtë parkingjeve? Që në kontratë e kanë një shumë tjetër ndërsa inkasimi është një shumë tjetër që auditori e ka gjetë aty që nuk është bë as inkasimi i mjeteve në përputhje me kontratat që janë nënshkru përmes operatorëve dhe komunes!

Znj.Hajrije Haxhijaj: nuk ka qenë materieale ajo, nese e kalon shumën e buxhetit 40 milionë i ki pas buxhet dhe nese ajo e kalon mbi 400 mijë euro që nuk i kemi inkasu të hyrat e parkingjeve

athere normal që kish ndiku në opinion, ndersa ajo ka qenë 126 mijë sepse pse nuk janë inaksu është qeshtje tjetër !

Z.Berat Ganiqi:unë e kom të pa qartë se në çfarë cilësie jemi duke mar përgjigje, poletikishtë ne jemi parti politike, përfaqësuesë të qytetarëve këtu neva na takon prej zgjedhurit të kryetarit nivel politik. Nuk më intereson mua nivel të shërbyesve civil , si me mar tash një ofiqar dhe me u përgjigj për punët e drejtoratit të administrates, nuk është e nevojshme dhe s'kemi nevoj me bë avokatin sepse po na hupet debati më shumë mbas shërbyes civil se sa me përfaqësues politik!

Znj.Hajrije Haxhijaj: Berat, ligji mbi menaxhimin e financave publike ZKF-ja mundet me zëvendësu shumë kënd.

Z.Berat Ganiqi: unë nuk replikoj, znj.Hajrije jeni duke e shkel komplet ligjin dhe rregullore kur drejtori është këtu!

Nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit me 5 votë pro, 2 votë të përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i raportit financiar të Komunës së Pejës për periudhën Korrik – Shtator 2024.

Znj.Diellza Berisha: raportin që e kemi dorëzu është si Draft-raport për shkak se punimi i këtij raporti fillon mbas datës 1, ka disa lëshime që kanë me u përmisu dhe ka me ardh materiali prap për kuvend. Në raport vetem në pika të shkurta shpenzimi i buxhetit deri në qet periudhë të cilën po flasim është 83.67%. Pjesa më e madhe e shpenzimit të buxhetit i takojnë pagave dhe meditjeve, dhe po e them prap jo që po dojmë me përmend por kontrata kolektive ka ndiku shumë në secilën pikë. Sepse na ka dëmtu shumë edhe në kategorit tjera, e jo vetem tek pjesa e kategorisë paga dhe meditje. Për dallim nga vitet e kaluara një progresë e kemi arrit tek investimet kapitale ku kemi arit me realizu 37.60% më shumë se vitin paraprak. Po ashtu sa i perket të hyrave vetanake deri tash i kemi 70 % të realizimit të të hyrave vetanke pa i llogarit gjobat që vin në fund të muajit.

Z.Labinot Panxha: meqenëse drejtoresha e përmendi që ky draft ka me pas ndryshme, nuk besoj që duhet me shku prej ktu pa e dit se qka ka me u ndryshu në këtë draft, prej anes tonë po flas! Gjithashtu u përmend edhe përqindja e shpenzimeve të buxhetit dhe po ashtu u përmend edhe që pjesa më e madhe është e pagave dhe meditjeve. Unë, si pyetje po j'u parashtroj se a është pjesa tjetër e shpenzume prej përmbaruesit që i ka mar paret apo në projekte që kanë qenë të parapara të cilat nuk është dasht me u prek drejtë për drejtë mirëqenja e qytetarit?

Znj.Diellza Berisha: 26.7% komplet të buxhetit është shpenzu tek investimet kapitale dhe pjesa tjere është e ndame!

Z.Labinot Panxha: po shihet që ky buxhet është shpenzu jo në rregullë dhe jo duke i plotësuar kërkesat e qytetarëve të cilat i keni parapa ju në realizim të atyre projekteve.

Z.Berat Ganiqi: ne jemi duke e pa që kontarten kolektive nuk mundemi me ndryshu, dhe prap nuk jam t'u e kuptu se qysh është kështu planifikimi me hy në një marrveshje dhe me hek njëhere përgjithmonë si borgjë. Fjalën e kam që duhet me gjet një zgjidhje se krejt qka është duke u bë me kontratë kolektive asnjë komunë nuk jam duke e kuptu, a janë duke e ditë se sa shpenzimet janë duke i bo tek përmbaruesi dhe qfarë shpenzime janë duke bo në kamat! Sepse ata janë duke i fitu, kur e ka fitu një kanë me fitu edhe 101 tjera, sespe nuk ka rregullë tjetër që e ndryshon. Dhe nuk e di qka po presin jo vetem komuna e Pejës por secila komunë tjetër, nuk pritet! Duhet me u ulë me llogarit sespe kështu na murr përçindjen e madhe në investime kapitale, e ka me mar edhe shumë tjera sepse harro që ka me ndryshu diqka, vetem qohet nese ne nje mengjes kjo qeveri ose tjera thotë na po i pagujmë. Mirpo as ashtu nuk shkon sespe me planifikim buxhetor shkon, vetem ketu e kam hallin e shqetësimin, sepse nuk e dim as sa arsimitar e kanë padit komunën, sa janë në proces? një jurist që e përfaqëson komunën pak a shumë duhet me dit se ku ka me hup një landë! Për ata unë e shoh të arsyeshme me hy në një marrveshje të cilën j'u pagun gradualishtë.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit raporti financiar të Komunës së Pejës për periudhën Korrik – Shtator 2024.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i informatës për gjendjen ekonomiko-financiare në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: raporti i informatës mbi gjendejen ekonomike- financiare e bën kryetari por ne sot se kemi prezent, nese kish me qenë mirë ne seancë të kuvendit me diskutu!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 votë pro, 2 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim informatë për gjendjen ekonomiko-financiare në Komunën e Pejës.

8.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë rënditje siç janë pranuar:

Nuk ka pasur.

Pjesë e këtij procesverballi është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:05 h.

**Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina**

**K R Y E S U E S I,
z. Rexhep Kurtbogaj**

DRAFT - Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025

	Rendi i Ditës	Hartues	Propozues	Shqyrtues	Miraton
JANAR 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata e kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës	Kryetari	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Raporti i punës së Kryetarit të Komunës nga viti paraprak	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025	Zyra e Prokurimit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2025	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i raportit informativ i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata e policisë për sigurinë në Komunën e Pejës	Policia Kosovës/ SP Pejë	Kryetari/Kryesuesi	KK	
SHKURT 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata mbi procesin e legalizimit të objekteve në Komunën e Pejës	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi inspektimin e ndërtimeve në Komunën e Pejës	Drejtoria e Inspektionit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozimit të Kryesuesit për dhënjën e autorizimit DKRS-së nga Kuvendi për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falenderime	Kryesuesi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Shqyrtimi i propozimit të Kryesuesit për formim e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, mirënjohjeve dhe falenderimeve nga Kuvendi i Komunës Pejë	Kryesuesi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata nga realizimi i planit të prokurimit nga viti paraprak	Zyra e Prokurimit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qelimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
MARS 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Shqyrtimi i raportit final financiar të Komunës së Pejës për vitin 2024	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Planit të Zyres për Komunitete për vitin aktual	Zyra për Komunitete	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe plani për ndarjen e tyre për vitin 2025	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
PRILL 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pasqyruar nga viti i kaluar në vitin aktual	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Shqyrtimi i progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa / Ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi listen e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre	Drejtoria për Çështje Pronore Juridike	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informates tre mujore financiare të Komunës së Pejës për periudhën Janar – Mars 2024	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi funksionimin e keshillave lokale në Komunën e Pejës	Drejtoria e Administratës	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata për të mbjellurat vjetore dhe pranverore	Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Hidroekonomisë	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
Vizitë studimore - jasht vendit	Kuvendi i Komunës				
MAJ 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Formimi i grupit punues për hartimin e planit të veprimit për proces transparent të buxhetimit	Kuvendi i Komunës	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Pejës	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi Qarkoren e parë buxhetore të MF-së	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
QERSHOR 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së	Koordinatori i KKS-së	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Seanca Soleme për nder të Ditës së Çlirimit të Pejës	Kryesuesi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Miratimi i KAB-it 2026-2028	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata mbi zhvillimin ekonomik dhe të turizmit në Komunën e Pejës	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Rishikimi i Buxhetit të Komunes për vitin 2025	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
KORRIK 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Raporti i punës së Kryetarit të Komunes për gjashtë mujorin e parë 2025	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe Planin e Veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2024	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi qarkoren e dytë buxhetore të brendshme komunale	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi performancën e komunes së Pejës (janar - dhjetor 2024)	Koordinatori për Performancë	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës së Pejës për periudhën Janar – Qershor 2025	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Themelimi i grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026	Kryesuesi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
Informata për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmërisë dhe testit të matures	Drejtoria për Arsimit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK		
GUSHT 2025	Pushim				
SHTATOR 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2025	Kryetari/ekzekutivi /Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata nga drejtori "KRU Hidrodrini" për gjendjen me furnizim me ujë në Komunën e Pejës	Drejtori "KRU Hidro Drini"	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi fillimin e vitit të ri shkollor	Drejtoria për Arsim	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata nga NPL Ambientit për gjendjen e grumbullimit të mbeturinave në Komunën e Pejës	Drejtori i "KRM Ambientit"		KPF/KK	
TETOR 2025		Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Shqyrtimi i progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit	Kryetari/ekzekutivi /Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2026	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata për gjendjen ekonomiko-financiare në Komunën e Pejës	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Vizitë studimore - jasht vendit	Kuvendi i Komunës	Kryetari/Kryesuesi		
NËNTOR 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS)	Koordinatori i KKS-së	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata mbi ndarjen e bursave për studente	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Pejës për periudhën Korrik – Shtator 2025	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2026	Kuvendi i Komunës	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026	Kuvendi i Komunës	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
Informata mbi draft Planin paraprak Vjetor të Prokurimit Publik 2026	Zyra e Prokurimit	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK		
DHJETOR 2025	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	KK
	Informata nga Kryetari mbi Planin Vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2026	Kryetari	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Informata mbi punën e tyre nga komitetet dhe komisionet e Kuvendit të Komunës	Komisionet përkatëse	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Raporti mbi implementimin e rekomandimeve të Auditorit Brendshëm për vitin 2024	Kryetari/ekzekutivi	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	
	Raport Informativ nga NPL-të në Komunën e Pejës	Drejtorët e NPL-vë	Kryetari/Kryesuesi	KPF/KK	



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: , datë: Nëntor 2024.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2.pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit dhe Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date, **27 Nëntor 2024**, merr:

Draft - V E N D I M

Nr. 64/2024

mbi miratimin e Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025

1. **MIRATOHET** kalendari i takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025 në tekst siç është propozuar.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë kalendaret e takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025.
3. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e kuvendit dhe do të publikohet në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj

Vendimi ti dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit
2. Kryesuesit dhe anëtareve të Kuvendit
3. Arkivë.



KUVENDI I KOMUNËS PEJË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Kalendari i Takimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa – Pejë për vitin 2025

Muaji	Takimi	Data e dërgimit të materialit	Dita/Data e Takimit
Janar	Takimi i KPF	E Hënë 06. Janar 2025	E Enjte, 16. Janar 2025
Shkurt	Takimi i KPF	E Martë, 04. Shkurt 2025	E Premte, 14. Shkurt 2025
Mars	Takimi i KPF	E Martë, 04. Mars 2025	E Premte, 14. Mars 2025
Prill	Takimi i KPF	E Premte, 04. Prill 2025	E Mërkure, 16. Prill 2025
Maj	Takimi i KPF	E Hënë, 05. Maj 2025	E Enjte, 15. Maj 2025
Qershor	Takimi i KPF	E Mërkure, 04. Qershor 2025	E Marte, 17. Qershor 2025
Korrik	Takimi i KPF	E Premte, 04. Korrik 2025	E Mërkure, 16. Korrik 2025
<i>Gusht</i>	<i>PUSHIM VJETOR</i>	<i>PUSHIM VJETOR</i>	<i>PUSHIM VJETOR</i>
Shtator	Takimi i KPF	E Premte, 05. Shtator 2025	E Mërkure, 17. Shtator 2025
Tetor	Takimi i KPF	E Hënë, 06. Tetor 2025	E Enjte, 16. Tetor 2025
Nëntor	Takimi i KPF	E Martë, 04. Nëntor 2025	E Premte, 14. Nëntor 2025
Dhjetor	Takimi i KPF	E Enjte 04. Dhjetor 2025	E Marte, 16. Dhjetor 2025

- Shënim:** a) Të gjitha takimet e theksuara më lartë do të mbahen me fillim në orën 11:00.
b) Takimet e jashtëzakonshme mund të mbahen në kushtet të përcaktuara me nenin 44. paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
c) Takimet mbahen në afatin e caktuar, por për arsye objektive data e caktuar dhe ora, mund të lëvizin apo takimi të mbahet ndonjë ditë më vonë se që është caktuar me këtë kalendar.



KUVENDI I KOMUNËS PEJË

Kalendari i Takimeve të Kuvendit të Komunës së Pejës, për vitin 2025

Muaji	Takimi	Data e dërgimit të materialit	Dita/Data e Takimit
Janar	Takimi i K.K.	E Enjte, 16. Janar 2025	E Martë 28. Janar 2025
Shkurt	Takimi i K.K.	E Premte, 14. Shkurt 2025	E Mërkurë, 26. Shkurt 2025
Mars	Takimi i K.K.	E Premte, 14. Mars 2025	E Enjte, 27. Mars 2025
Prill	Takimi i K.K.	E Mërkure, 16. Prill 2025	E Hënë, 28. Prill 2025
Maj	Takimi i K.K.	E Enjte, 15. Maj 2025	E Martë, 27. Maj 2025
Qershor	Takimi i K.K.	E Marte, 17. Qershor 2025	E Premte, 27. Qershor 2025
<i>Qershor</i>	<i>Takim publik me qytetar</i>	<i>Takimi i parë publik</i>	<i>E Enjte me dt. 26.06.2025</i>
Korrik	Takimi i K.K.	E Mërkure, 16. Korrik 2025	E Hënë, 28. Korrik 2025
<i>Gusht</i>	<i>PUSHIM VJETOR</i>	<i>PUSHIM VJETOR</i>	<i>PUSHIM VJETOR</i>
Shtator	Takimi i K.K.	E Mërkure, 17. Shtator 2025	E Hënë, 29. Shtator 2025
Takim	Takimi i K.K.	E Enjte, 16. Tetor 2025	E Marte, 28. Tetor 2025
Nëntor	Takimi i K.K.	E Premte, 14. Nëntor 2025	E Mërkurë, 26. Nëntor 2025
Dhjetor	Takimi i K.K.	E Marte, 16. Dhjetor 2025	E Hënë, 29. Dhjetor 2024
<i>Dhjetor</i>	<i>Takim Publik me qytetar</i>	<i>Takim i dytë publik</i>	<i>E Premte, dt. 26. Dhjetor 2025</i>

- Shënim:** a) Të gjitha takimet e theksuara më lartë do të mbahen me fillim në orën 10:00.
b) Takimet e jashtëzakonshme mund të mbahen në kushtet të përcaktuara me nenin 44. paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
c) Takimet mbahen në afatin e caktuar, por për arsye objektive datat e caktuara mund të lëvizin apo takimi të mbahet ndonjë ditë më vonë se që janë caktuar me këtë kalendar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Pejës
Opština Peć – Municipality of Peja

PLANI LOKAL I VEPRIMIT
PËR
BARAZINË GJINORE

2024 - 2027

Nëntor, 2024

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2027 u përgatit nga Komuna e Pejës me mbështetjen e UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Grupi Punues

1. Xhenet Syka – Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
2. Nita Panduri Mullarama – Drejtoreshë për Administratë
3. Diellëza Berisha – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
4. Naser Gega – Drejtor i Drejtorisë për Arsim
5. Albulena Bajraktaraj – Drejtoreshë e Mirëqenies Sociale
6. Avni Gashi – Sekretar i Kuvendit Komunal
7. Pandeli Rugova – Udhëheqës i Zyrës Ligjore
8. Gazmend Turku – Shef i Buxhetit
9. Agim Mala – Shef i Qendrës për Shërbime për Qytetarë
10. Samka Drançolli- Zyrtare për Barazi Gjinore
11. Dafina Draga - Asambleiste
12. Mubera Belegu - Asambleiste
13. Hidajete Krasniqi - Asambleiste
14. Xhevaire Çeku Kelmendi – Asambleiste
15. Raisa Nurkoviç – Kryetare e OJQ

Ekspertiza teknike nga UN Women / GEF:

Artan Binaku, Koordinator Projekti

Monika Kocaqi, Konsulente ndërkombëtare

DRAFT

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE	5
I. HYRJE	6
II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE	8
III. METODOLOGJIA	11
IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE	12
V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2024 - 2026.....	16
VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	19
VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024-2026.....	20

DRAFT

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ABGJ	Agjencia për Barazinë Gjinore
BDPfA	Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DA	Drejtoria e Arsimit
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DBPH	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë
DÇPJ	Drejtoria për Çështje Pronëso-ro-Juridike
DKGJ	Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi
DMS	Drejtoria për Mirëqenie Sociale
DMSH	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DPI	Drejtoria për Punë Inspektuese
DPKSHP	Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike
DSE	Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GGKP	Grupi i Grave të Kuvendit të Komunës së Pejës
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KK	Kuvendi i Komunës
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ON	Organizatë Ndërkombëtare
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore
PLVBGJ	Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SDG	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
ZBGJ	Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore
ZK	Zyra e Kryetarit

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2027 u përgatit nga Komuna e Pejës, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mos diskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritimit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndëreveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin e Grave të Kuvendit të Komunës së Pejës, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin e Komunës dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Pejës, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).¹

Siç përkrahur edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale², njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave³, të rejave dhe të rinjve⁴, vajzave dhe djemve.⁵

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifike për zbatimin e të cilave duhet të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.

¹ Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

² Tekstin e Kartës mund ta gjeni në: <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>

³ “Gra dhe burra” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

⁴ “Të reja dhe të rinj” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 29 vjeç.

⁵ “Vajza dhe djem” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

“Peja qytet në të cilin vlen të jetohet dhe të vizitohet”⁶ është prezantimi që Komuna e Pejës bën që në ballinën e faqes zyrtare të internetit, ndërkohë që nëse shfleton dokumentet dhe strategjitë kryesore të komunës, evidentohen qartazi përpjekjet për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve, me qëllim që të gjitha / gjithë banoret dhe banorët e Pejës, pavarësisht moshës, gjinisë, vendit ku banojnë, etnisë dhe çdo karakteristike tjetër individuale, të trajtohen me profesionalizëm e në mënyrë të barabartë, duke shtuar vëmendjen ndaj grupeve në nevojë, me qëllim që askush të mos mbetet pas.

Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, si dhe në përputhje me misionin dhe vizionin e saj, Komuna e Pejës, ka emëruar një Zyrtare për Barazinë Gjinore e cila harton dhe zbaton plane të punës për përparimin drejt barazisë gjinore. Këto plane e kanë gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga komuna dhe donatorë, përmes partneriteteve e bashkëpunimit.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel kombëtar apo lokal, duhet të pranohet që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikën, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

